

Asylum Support Partnership

help and advice



January 2010

Albanian

Pagesa amësie për prindërit që kërkojnë azil

Nëse keni marrë mbështetje financiare për azil nga Agjencia Britanike e Kufirit (UK Border Agency - UKBA), dhe jeni shtatëzanë, ose nëse keni fëmijë nën moshën tre vjeçare, ju keni të drejtën për të tërhequr para shtesë. Kjo fletëpalosje shpjegon se cilat pagesa janë të disponueshme për ju, dhe çfarë keni nevojë të bëni në mënyrë që t'i përfitonit këto pagesa. Për të marrë para shtesë ju duhet të ndiqni të gjithë hapat siç shpjegohet si mëposhtë brenda afateve kohore të përcaktuara.

Pagesat javore shtesë me para në dorë

Ndërsa jeni shtatëzanë dhe fëmija ka lindur, ju mund të merrni pagesa shtesë nga UKBA. Kur jeni shtatëzanë ju mund të kërkonit £3 shtesë në javë. Kur fëmija juaj ka lindur, dhe dersia ajo ose ai të ketë mbushur një vjeç, ju keni të drejtën të merrni edhe £5 të tjera në javë. Kur fëmija juaj bëhet një vjeç ju do keni të drejtën të merrni £3 shtesë në javë derisa fëmija të bëhet 3 vjeç. Kur fëmija bëhet tre vjeç pagesat shtesë do të ndërpriten dhe pagesa javore do të jetë ajo aktualja siç përcaktohet nga UKBA për prindërit dhe fëmijët.

Nëse jeni duke marrë mbështetje financiare të Seksionit 4 (Section 4 support), ju mund të aplikoni edhe për pagesa të tjera të ngjashme. Për më tepër, kur fëmija ka lindur, ju mund të aplikoni për një shtesë prej £5 në javë për të paguar veshmbathjet e fëmijës suaj deri kur të ketë mbushur 16 vjeç. Të gjitha pagesat shtesë që merrni do të vendosen në kartën Azure të pagesave. Nëse keni fëmijë që janë nën moshën 18 vjeç, atëherë nuk ka kufizime për shumën e mbështetjes financiare që mund të mbani në karën tuaj Azure javë pas javë. Nëse ky është fëmija i parë, UKBA do ta heqë kufizimin prej £5 mbi kufirin e përcaktuar të shumës financiare në kartë, pasi ju të keni marrë zyrtarisht fondin e amësisë.

Një fond shtesë i vetëm amësie

Kur fëmija lind dhe ju merrni mbështetje financiare azili të zakonshme, ju keni gjithashtu të drejtë të merrni një fond të vetëm shtesë prej £300 për të mbuluar shpenzimet e veshmbathjeve dhe pajisjeve të tjera për fëmijën. Nëse lindni binjakë atëherë ju do të merrni £600, £300 për çdo fëmijë. Për këtë fond ju duhet të aplikoni jo më herët se gjashtë javë para se fëmija të lindë ose jo më vonë se dy javë që nga dita që fëmija ka lindur.

Nëse po merrni një mbështetje financiare të Sektorit 4, ju mund të aplikoni për një pagesë të vetme shtesë prej £250 për fëmijë. Nëse keni binjakë ju keni të drejtë të merrni £500. Kjo shumë do t'i shtohet kartës suaj të pagesave Azure. Për këtë pagesë duhet të aplikoni jo më herët se tetë javë para lindjes së fëmijës, ose jo më vonë se gjashtë javë që nga lindja e tij.

Fletëpalosje të tjera të përkthyer janë të disponueshme tek <http://languages.refugeecouncil.org.uk>

Çfarë duhet të bëj unë dhe kur?

Për të marrë këto pagesa ju duhet të dërgoni një kërkesë të shkruar dhe të firmosur tek UKBA. Nëse jeni duke marrë mbështetje financiare të Sektorit 4 nga UKBA, atëherë të gjitha kërkesat duhet t'i kryeni duke përdorur Formularin Për Pagesat Shtesë të Sektorit 4 dhe të vendosni një shenjë në të gjitha kutitë që i përshtaten rastit tuaj. Kërkesat duhet të dërgohen tek personi që ndjek çështjen tuaj (case owner). Nëse nuk keni një person që është ngarkuar për çështjen tuaj, ju duhet t'i shkruani zyrës rajonale të UKBA

Për çdo kërkesë ju duhet të dërgoni dokumentat origjinale të cilat UKBA më pas duhet t'ju kthejë mbrapsh. Gjithashtu, duhet që të bëni një fotokopje të të gjithë kërkesave dhe dokumentave tuaja, për t'i mbajtur vetë një kopje. Të gjitha kërkesat dhe dokumentat origjinale duhet t'i dërgoni nëpërmjet "postës rekomandë" (recorded delivery) (për këtë pyesni tek Zyra Postare).

Nëse keni nevojë për ndihmë gjatë plotësimit të këtyre aplikimeve, atëherë kontaktoni organizatën për refugjatët në zonën tuaj.

Kur bëheni shtatëzanë:

Shkruajni personit që merret me çështjen tuaj pranë UKBA për t'i kërkuar pagesën e amësisë prej £3 dhe fondin e vetëm të amësisë prej £300/£250, duke përfshirë bashkë më të dhe një letër ose një formular MATB1 të plotësuar nga doktori apo mamia juaj, të cilët konfirmojnë që ju jeni shtatëzanë si dhe datën e lindjes së fëmijës.

Kini parasysh që këto kërkesa për fondin e amësisë t'i dërgoni brenda afateve kohore sië specifikohet nga UKBA:

- Nëse ju po merrni mbështetje financiare të zakonshme, atëherë kërkonit shumën prej £300 jo më herët se gjashtë javë para lindjes së fëmijës, ose jo më vonë se dy javë pasi fëmija ka lindur.
- Nëse ju po merrni mbështetje financiare të Sektorit 4, atëherë kërkonit shumë prej £250 jo më herët se tetë javë para se fëmija të lindë, ose jo më vonë se gjashtë javë pasi fëmija ka lindur.

Nëse aplikoni më herët, UKBA ndoshta nuk e shqyrton aplikimin tuaj. Ju lutemi kontrolloni nëse do ju duhet ta ridërgoni kërkesën brenda afatave kohore të përcaktuara. Në disa raste UKBA nuk do ta miratojë fondin e amësisë derisa fëmija të ketë lindur, dhe do të kërkojë konfirmim për lindjen e fëmijës (psh çertifikatën e lindjes - birth certificate).

Ju lutem vini re, nesë nuk aplikoni brenda afateve kohore të përcaktuara ju nuk do të merrni asnjë pagesë.

Kur fëmija juaj ka lindur:

Shkoni pranië zyrës suaj të regjistrimit dhe regjistroni lindjen sa më parë që të jetë e mundur. Ata do t'ju japin falas një çertifikatë të "shkurtër" lindjeje. Ju mund të merrni gjithashtu një çertifikatë më të "gjatë" lindjeje kundrejt një pagese të vogël. **Për të aplikuar ju duhet t'i merrni të dyja llojet e çertifikatave.** Nëse jeni duke marrë mbështetje financiare të Sektorit 4, atëherë ju mund të kërkonit para nga UKBA për të paguar çertifikatën e gjatë të lindjes.

Për t'u siguruar që fëmija juaj do i shtohet mbështetjes financiare, duhet të nënshkruani një kërkesë të shkruar dhe t'ja dërgoni atë personit që merret me çështjen tuaj. Aty duhet të përfshini gjithashtu

dhe çertifikatën e "gjatë" të lindjes. Në momentin që UKBA ka marrë aplikmin, ajo do i shtojë pagesat e përshkruara si mësipër tek mbështjeja juaj financiare e azilit.

Nëse pagesat nuk kanë nisur brenda dy ose tre javëve, atëherë kontakoni organizatën për refugjatë në zonën tuaj.

Nëse nëna nuk është e pranishme, baballarët që kujdesen për fëmijët e tyre vetëm, mund të ndjekin të njëjtat procedura për të kërkuar mbështetje financiare shtesë.

Asylum Support Partnership consists of:

North of England Refugee Service, charity number: 1091200 www.refugee.org.uk
Refugee Action, charity number: 283660 www.refugee-action.org.uk
Refugee Council, charity number: 1014576 www.refugeecouncil.org.uk
Scottish Refugee Council, charity number: SC008639 www.scottishrefugeecouncil.org.uk
Welsh Refugee Council, charity number: 1102449 www.welshrefugeecouncil.org